



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 51, datë 23.07.2025

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 25, DATË 03.02.2023 , VKB-SË NR.85, DATË 29.07.2024, VKB-SË NR. 190, DATË 22.12.2023 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO PËRFITOJNË SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", të ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar; Urdhëri i Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 03.02.2023 "Për miratimin e listës së trembëdhjetë paraprake të 49 familjeve, që kanë humbur

shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, duke hequr nga kjo listë, z. Kadri Gjyli, listuar me nr. 8 në aneksin 1.

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 85, datë 29.07.2024 “Për miratimin e listës së trembëdhjetë paraprake të 49 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, duke hequr nga kjo listë z. Muharrem Sula, listuar me nr. 2 në aneksin 1.
3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 85, datë 29.07.2024 “Për miratimin e listës së trembëdhjetë paraprake të 49 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, duke hequr nga kjo listë z. Ervin Sula, listuar me nr. 1 në aneksin 1.
4. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 190, datë 22.12.2023 “Për miratimin e listës së trembëdhjetë paraprake të 49 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, duke hequr nga kjo listë znj. Mizijen Konduri, Petro Konduri, Eno Konduri, Iva Konduri, listuar me nr. 5 në aneksin 1.
5. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 190, datë 22.12.2023 “Për miratimin e listës së trembëdhjetë paraprake të 49 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, duke hequr nga kjo listë z. Sali Kurti, listuar me nr. 1 në aneksin 1.
6. Miratimin e subjekteve përfitues të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	PRONARI	ZONA E RE PER ZHVILLIM E MIRATUAR	ZONA E RE PER ZHVILLIM E NDYRSHUAR
1	KADRI GJYLI	SPITALLE	4 BANESAT KOLEKTIVE LAGJJA 17
2	MUHARREM SULA	SPITALLE	4 BANESAT KOLEKTIVE LAGJJA 17
3	ERVIN SULA	SPITALLE	4 BANESAT KOLEKTIVE LAGJJA 17
4	ENO KONDURI, IVA KONDURI, MIZIJEN KONDURI, PETRO KONDURI	SPITALLE	4 BANESAT KOLEKTIVE LAGJJA 17
5	SALI KURTI	SPITALLE	4 BANESAT KOLEKTIVE LAGJJA 17

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.07.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 511 prot.
15

Durrës, më 24 . 07.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 51 datë 23.07.2025 “Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 25, datë 03.02.2023 , VKB-së nr. 85, datë 29.07.2024, VKB-së nr. 190, datë 22.12.2023 për sa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve përfituese të cilët do përfitojnë si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

